



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Përftimi i kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr.475 Prot., datë 17.08.2018 “Njoftim përqendrimi nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga Bconnect SHPK”, përfaqësuesi ligjor i palës blerëse ka njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga Bconnect SHPK.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar dokumentit “Kontratë shitblerje për pjesëmarrje në shoqëri ” palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

BConnect SHPK është një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar. Kjo shoqëri është një shoqëri e specializuar në dhënien e shërbimeve të asistencës telefonike në favor të palëve të treta, që e realizon duke vendosur kontakte telefonike në vijim të thirrjeve hyrëse (inbound) dhe dalëse (outbound)¹.

Shoqëria BConnect SHPK i zotërohet tërësisht nga shoqëria e të drejtës italiane Covisian S.p.A.

Aksioneri, shoqëria Covisian S.p.A. është e themeluar sipas ligjit italian. Aktivitet i kësaj shoqërie janë shërbimet e lidhura me marketingun e shoqërive si telekontakti, postimi dhe çdo shërbim i kryer me sistemet telematike (përfshirë internetin)². Shoqëria Covisian S.p.A. është lider në Itali në sektorin BPO dhe të kontakt center dhe në krye të grupit me të njëjtin emër “Covisian” që, me një xhiro prej rreth 130 milion Euro, është pjesëmarrësi numër dy i tregut italian të *Customer Operations*.³

Pala shitëse:

Doxa S.p.A, shoqëri e themeluar sipas ligjit italian, dhe ka për objekt, ekzekutimin për llogari të vet dhe për llogari të të tretëve, të vrojttimeve statistikore dhe të përpunimit të informacioneve, të cilat grumbullohen me referendum, intervista dhe në mënyra të tjera, edhe mbi të dhëna që janë aktualisht të disponueshme.

Shoqëria Doxa S.p.A, zotëron 100% kapitalin e shoqërisë Target.

¹Burimi: Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit.

²Burimi: Ekstraktit i shoqërisë Covisian S.p.A.

³Burimi: Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit

Shoqëria Grid SHPK (Target), është një shoqëri e së drejtës shqiptare. Shoqëria ka si objekt veprimtarie “Kërkime programe statistikore, aplikime informatike”.

Sipas informacionit të depozituar në formularin e njoftimit, Grid SHPK ofron shërbim edhe në tregun e shërbimit Call Center.

Në datë 20 korrik 2018, është nënshkruar “*Kontratë shitblerje për pjesëmarrje në shoqëri*” midis palës blerëse BConnect SHPK dhe palës shitëse Doxa S.p.A, në lidhje me blerjen e 100% të kapitalit të Grid SHPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.